

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"R&L BUILDING" SHPK**

Sot, më datë 06/08/2024, u paraqit personalisht:

- Zj. Laura Mehmetaj, e datëlindjes 26/11/2001, shtetase shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtese e kartës se identitetit me Nr. 035674572 dhe Nr. Personal K16126065I.**

I cili përpiloj këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare "R&L BUILDING" SH.P.K, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**  
**Forma Ligjore**

Të themeloj Shoqërinë Tregtare "R&L BUILDING" SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "R&L BUILDING" SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2**  
**Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3**  
**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit "R&L BUILDING" SH.P.K dhe me emrin tregtar **R&L BUILDING**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4**  
**Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

Ndërtimi, restaurim dhe mirëmbajtja e ndërtesave civile të larta dhe industriale. Ndërtimin në përgjithësi dhe në vezantë. Ndërtim i të gjitha llojeve, ndërtesave rezidenciale dhe jorezidenciale. Ndërtesa qytetare dhe vepra të lidhura e plotësuese. Konstruksione të ndryshme brenda fushës së ndërtimit. Ndërtimi dhe mirëmbajta e rrugëve. Punime rrugore speciale, shtrime speciale, stabilizim terrenesh, shenja të qarkullimit dhe të sigurisë. Punime hidraulike speciale, gazsjellës, vajgur sjellës, impiante pompimi, impiante të ujit të pijshëm, impiante të depurimit, shpime dhe puse, izolime përshkueshmërie dhe izolime special të

përshkueshmërisë. Punime veprash speciale të ndryshme, rilevime topografike speciale, eksplorime të nëntokes me mjete speciale, themelë special.

#### **NENI 5**

##### **Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Rr. Sokrat Miho, Kompleksi Fratari, Godina 3, Shkalla 2, Zyra Nr. 12.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

#### **NENI 6**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar është Lekë 100.000 (njeqind mijë leke) dhe zotërohet nga ortaket themelues:

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: Lekë 100.000 (njeqind mijë leke)

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1.

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku themelues.

#### **NENI 7**

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare "R&L BUILDING" SH.P.K zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Ortaku themelues :	<b>Laura Mehmetaj</b>
Numri i kuotave :	<b>1</b>
Numri i pjeseve :	<b>1</b>
Pjesemarrja ne Shoqeri :	<b>100,00 %</b>
Lloji i kontributit:	<b>Ne para</b>
Vlera e kontributit	<b>100,000 ( njeqind mijë) leke</b>

Duke qene se Kapitali themeltar do te depozitohet ne llogarine e Shoqerise e cila do te hapet pas rregjistrimit ne QKB, atehere ortaku vendos qe kjo shume do te paguhet prej tij jo me vone 3 muaj nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB, ne llogarine e shoqerise tregtare.

Rregullat e pageses se kesaj shume jane parashikuar ne kete Statut.

#### **NENI 8**

##### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

#### **NENI 9**

### **Administratori/ët**

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqerise do te jetë :

- **Zj. Laura Mehmetaj, e datëlindjes 26/11/2001, shtetase shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtese e kartës se identitetit me Nr. 035674572 dhe Nr. Personal K16126065I.**

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

### **NENI 10**

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjeter privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

### **NENI 11**

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar përfaj të tyre.

### **NENI 12**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

### **NENI 13**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues, u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe, duke qene se ortaku eshte njohes i gjuhes shqipe.

### **ORTAKU THEMELUES**

**Laura Mehmetaj**

